



Partnership | Progress | Prosperity



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Raport Përfundimtar

Për vëzhgimin
e Zgjedhjeve
Parlamentare
të dt. 11 Maj
2025

Publikuar në, Gusht 2025



Raport Përfundimtar

Për vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare të dt. 11 Maj 2025

Publikuar në, Gusht 2025



Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Raport përfundimtar i Komitetit Shqiptar të Helsinkit për vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare të dt. 11 Maj 2025.

Përgatiti: Z. Emanuel Xhindi, Asistent Projektsh pranë Komitetit Shqiptar i Helsinkit
Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rishikoi: Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është hartuar në kuadër të nismës “Ndërtimi i integritetit elektoral dhe qëndrueshmërisë së partive politike: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në partneritet me Instituti i Studimeve Politike, Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania, mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Tiranë.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike në Tiranë dhe të organizatave partnere të KSHH-së.

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: +355 69 40 75 732

E-mail: office@ahc.org.al

Web site: www.ahc.org.a



Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tryeza e lëndës

Hyrje	3
Përmbledhje Ekzekutive	4
1. Metodologjia e Monitorimit	6
2. Procesi parazgjedhor	7
3. Heshtja Zgjedhore	15
4. Procesi i Dorëzimit dhe Shpërndarjes së Materialeve Zgjedhore	16
5. Monitorimi i ditës së Votimit.....	17
6. Procesi i numërimit.....	22
7. Rekomandime	24



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (në vijim “KSHH”) është organizatë jofitimprurëse e themeluar më 16 dhjetor të vitit 1990. Misioni i KSHH-së është të kontribuojë në respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit ligjor, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Ushtrimi i së drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur është e drejtë themelore, e sanksionuar në Kushtetutë. KSHH është angazhuar vazhdimisht në monitorimin të zgjedhjeve prej vitit 1996, duke e shtrirë monitorimin përtej procesit të votimit dhe numërimit të votave.

Me një ekip prej 145 Vëzhguesish afatgjatë dhe afatshkurtër, KSHH vëzhgoi procesin parazgjedhor, procesin e votimit dhe të numërimit të zgjedhjeve parlamentare të dt.11 maj 2025, duke e shtrirë monitorimin në 113 bashki të vendit. Vëzhguesit e KSHH-së u udhëzuan dhe u trajnuan paraprakisht mbi metodologjinë e zhvillimit të monitorimit. Legjislacionin zgjedhor, parimet dhe mënyrat e raportimit.

KSHH falenderon dhe i është mirënjohës të gjithë vëzhguesve dhe korrespondentëve vendorë për objektivitetin, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin dhe përkushtimin e tyre.

Përgjatë monitorimit të procesit parazgjedhor të zgjedhjeve të fundit parlamentare, KSHH u përqëndrua në çështjet lidhur me publikimin e listave zgjedhore, njoftimit me shkrim të zgjedhësve, vendimarrjen e organeve të KQZ (në vijim “KQZ”), ngritjen dhe funksionimin e administratës zgjedhore, mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore dhe ndalimit të përdorimit të burimeve shtetërore. Monitorimi ynë ka synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, llogaridhënies, transparencës dhe përgjegjshmërisë së institucioneve përkatëse lidhur me garantimin e integritetit të procesit zgjedhor.

Vëzhguesit e KSHH mbuluan 163 Qendra Votimi (në vijim “QV”), dhe, gjatë procesit të numërimit të votave mbuluan 12 Vende të Numërimit të Votave (në vijim “VNV”) KSHH.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të realizojë një vlerësim sa më gjithëpërfshirës të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare të dt.11 Maj 2025, duke u mbështetur në gjetjet dhe konkluzionet kryesore të monitorimit të fazave më të rëndësishme të tij. Përmes këtij vlerësimi synohet të identifikohen praktikat pozitive, sfidat dhe mangësitë që mund të kenë ndikuar në integritetin dhe transparencën e procesit zgjedhor. Vëmendje e veçantë i kushtohet analizës së përputhshmërisë së zhvillimit të zgjedhjeve me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ky raport synon gjithashtu të kontribuojë në përmirësimin e proceseve zgjedhore në të ardhmen, duke ofruar rekomandime si në drejtim të nevojës për përmirësimin e ligjit dhe zbatueshmërisë së tij në praktikë, drejtuar institucioneve përgjegjëse dhe partive politike. Raporti synon të japë një pasqyrë të qartë dhe të argumentuar të cilësisë së procesit zgjedhor dhe të ndikojë pozitivisht në rritjen e besimit publik ndaj institucioneve që e administrojnë atë.

Përmbledhje Ekzekutive

Procesi për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë i datës 11 Maj 2025 u zhvillua në një klimë të ndërlikuar politike dhe sociale, ku përballë sfidave të shumta teknike dhe organizative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tregoi përpjekje të vazhdueshme pro-aktive për të siguruar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Këto zgjedhje jetësuan për herë të parë në këto 35 vite demokraci, votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe banojnë jashtë vendit, direkt nga këto vende, i njohur ndryshe si vota e diasporës.

Megjithatë, vëzhguesit e KSHH-së evidentuan problematika të shumta, shumica e të cilave të përsëritura nga monitorimet zgjedhore në të kaluarën, të cilat kërkojnë adresim dhe përmirësim të menjëhershëm të legjislacionit zgjedhor dhe zbatimit të tij efektiv, për të garantuar zgjedhje me integritet dhe më të besueshme në të ardhmen.

Stabiliteti i legjislacionit zgjedhor bazë është i një rëndësie të veçantë, por krahas zbatimit të këtij parimi, i rëndësishëm është edhe besueshmëria në procedurat që zbatohen për votuesit jashtë vendit. Një nga problemet që kërkon rishikim të kujdesshëm të legjislacionit zgjedhor është nevoja për parashikimin e garancive ligjore efektive që mundësojnë respektimin e parimit të fshehtësisë së votimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Kjo pasi në këto zgjedhje u sinjalizuan raste kur ky parim nuk u respektua (ku pati raste të publikimit të fletës së votimit në rrjetet sociale ose të perceptimeve mbi ndikimet me elementë të shpërdorimit të administratës publike në votën e emigrantëve familjarë të tyre).

Sipas nenit 77 të Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve, ndërsa ditën para datës së zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së procesit të votimit duhet të ketë heshtje zgjedhore. Por kjo dispozitë nuk u respektua, ndërkohë që dy partitë kryesore e filluan para kohe fushatën zgjedhore duke u fokusuar në vendet ku jetojnë emigrantët shqiptarë si Greqia, Italia, Anglia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj. Ka patur raste që KQZ-ja, për shkelje të kësaj dispozite ka vënë në dijeni subjektet zgjedhore, por në asnjë rast nuk ka marrë masa administrative edhe kur shkelje të tilla kanë vazhduar. Kjo situatë disavantazhoi partitë e vogla politike si dhe u shoqërua me mungesë të transparencës nga dy partitë kryesore për shpenzimet e fushatës brenda dhe jashtë vendit.

KSHH vëren se institucionet publike kanë përdorur artifica ligjore për t'iu shmangur fushës së veprimtari të kufizimeve të vendosura në dispozitat e Kodit Zgjedhor për shpërdorimin e aseteve



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

publike. Në disa raste, interpretimi i KQZ-së lidhur me këto kufizime është i një natyre të ngushtë (stricto sensu) që shkon përkundrajt frymës së ligjit zgjedhor për një garë të barabartë e të ndershme midis partive politike. Në raste të diskutueshme, do të kishte qenë i nevojshëm një hetim administrativ më i plotë dhe i gjithëanshëm nga KQZ, lidhur me këto raste që avantazhuan mazhorancën qeverisëse, sikurse është dhënia e bonusit të pranverës për pensionistët që pati efekt në periudhën 4 mujore të ndalimit, dhënia e nën-granteve nga Bashkitë gjatë periudhës 4 mujore, rastet e sinjalizuara për dhënien e ndihmës ekonomike, shpërdorimi i rrjeteve sociale të funksionarëve dhe institucioneve publike për qëllime zgjedhore, miratimi i aktit nënligjor për faljen e gjobave administrative po gjatë kësaj periudhe, etj. Asnjë nga ankesat që KSHH ka përcjellë drejt KQZ-së për raste të dyshuara të shpërdorimit të aseteve publike nuk rezulton të jetë ndëshkuar.

Sistemi i patronazhimit është raportuar nga korrespondentët dhe vëzhguesit e KSHH-së edhe në këto zgjedhje, edhe pse format në të cilat realizohet ai janë të sofistikuar dhe vështirësojnë identifikimin në terma konkret nga aktorë të jashtëm edhe të pavarur. Në këtë drejtim, shqetësues është angazhimi i nëpunësve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, në mbështetje të kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore, të organizuar sipas lagjeve apo njësive të caktuara. Për shkak të marrëdhënieve të tyre të varësisë, funksionit dhe detyrës që ata kryejnë, ekziston rreziku që në shpërdorim të saj, të krijohet një klimë nxitëse ose intimiduese ndaj zgjedhësve që preken drejtpërsëdrejti apo tërthorazi nga detyra dhe funksioni i tyre.

Gjatë ditës së votimit, problematika të tilla si mungesa e energjisë elektrike, defektet teknike në pajisjet PEI, por jo në nivele shqetësuese si në të kaluarën, si dhe angazhimi i aktivistëve partiakë në procedurat e verifikimit të votuesve ndikuan në rregullshmërinë e procesit. Prania e personave pa bexhe akreditimi, si dhe përpjekjet sporadike për ndikim mbi votuesit, janë tregues të dobësive në kontrollet e sigurisë dhe në zbatimin e ligjit zgjedhor, edhe pse si risi në këto zgjedhje ishte caktimi i dy koordinatorëve të sigurisë për Qendrat e Votimit nga KQZ.

Procesi i numërimit të votave, megjithëse kryesisht transparent dhe me pjesëmarrjen aktive të vëzhguesve, u ndesh me prezencën e personave të paautorizuar në vendnumërime dhe përpjekjet për të ushtruar ndikim mbi numëruesit. KSHH vëren se u cenua besueshmëria e publikut tek puna e komisionerëve që lexuan fletët e votimit pas ri-numërimit në disa Bashki të Vendi¹, edhe pse nuk pati ndryshime në rezultat. Këto sfida nënvizojnë nevojën për depolitizim të plotë të administratës zgjedhore, forcim të masave të sigurisë, llogaridhënie dhe përgjegjshmëri të administratës zgjedhore, e cila realizohet së pari me transparencë karshi publikut nga KQZ-ja për natyrën e “gabimeve njerëzore”, sikurse u cilësuan ato nga dy anëtarë të KAS-it në prononcime individuale për median dhe jo vendimmarrje kolektive të këtij organi kolegjal.

¹ Me ankesë të subjekteve zgjedhore u bë rinumërimi masiv i fletëve të votimit edhe në qytete të mëdha sikurse janë Tirana, Durrësi, Vlora, Fieri.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në aspektin mediatik, pavarësisht përpjekjeve për të siguruar një trajtim të barabartë të subjekteve politike në transmetimet televizive si dhe dedikimit të kohës më të kufizuar dhe joproporcionale nga disa televizione për partitë e vogla garuese, interesat e ndërlidhura midis qeverisë, biznesit dhe medias krijuan sërisht një mjedis të pabarabartë dhe avantazhues ndaj dy forcave kryesore politike. Veçanërisht këto dy forca politike kanë vijuar të vendosin në dispozicion të televizioneve materiale të gatshme të regjistruara, çka lejohet nga neni 84 i Kodit Zgjedhor, për të cilin OSBE/ODIHR ka rekomanduar rishikimin e tij.

1. Metodologjia e Monitorimit

Procesi i monitorimit u zhvillua në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislationin vendas për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe u mbështet në një qasje të integruar sasiore dhe cilësore. Qëllimi i kësaj metodologjie ishte të sigurohej një pasqyrë objektive, sa më gjithëpërfshirëse dhe e besueshme mbi zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha fazat e tij.

Monitorimi u shtri në një numër të përzgjedhur zonash zgjedhore që përfaqësonin karakteristika të ndryshme gjeografike, sociale dhe politike, duke përfshirë zona urbane dhe rurale, si dhe rajone me përvojë të mëparshme të problematikave zgjedhore. Përveç qendrave të zakonshme të votimit dhe komisioneve zonale të administrimit zgjedhor (KZAZ), një element i rëndësishëm i kësaj metodologjie ishte **monitorimi i votimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)**. Kjo përbën një hap të rëndësishëm drejt garantimit të së drejtës së votës edhe ata që ndodhen në kushte kufizuese të lirisë personale.

U angazhuan vëzhgues të trajnuar në mënyrë profesionale, mbi përmbajtjen e kuadrit ligjor zgjedhor, rregullat e sjelljes, si dhe udhëzime specifike për vëzhgimin e votimit në IEVP. Instrumenti kryesor i përdorur ishte **pyetësori i strukturuar**, i ndarë sipas fazave të procesit zgjedhor (heshtja zgjedhore, shpërndarja e materialeve, dita e votimit, numërimi i votave). Pyetësori përfshinte:

- **Pyetje të mbyllura**, të cilat lehtësojnë krahasimin dhe analizën statistikore;
- **Pyetje të hapura**, për regjistrimin e situatave të jashtëzakonshme ose të pa parashikuara;
- **Hapësira për komente cilësore**, që i mundësonin vëzhguesve të ofronin analiza të thelluara për raste specifike, veçanërisht në IEVP ku dinamika e votimit është më e ndërlikuar.

a. Grumbullimi, verifikimi dhe analizimi i të dhënave

Të dhënat u mbledhën në kohë reale ose pas përfundimit të çdo faze përmes formularëve (pyetësorëve) elektronikë apo fizikë, në varësi të kushteve të terrenit. U aplikua një proces rigoroz i verifikimit të të dhënave për të garantuar saktësinë, koherencën dhe besueshmërinë e informacionit të mbledhur. Në rastin e IEVP-ve, vëmendje e veçantë iu kushtua raportimit të



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

çështjeve që lidhen me qasjen në informacion, ushtrimin e lirë të votës dhe përmbushjen e procedurave ligjore të votimit të të dënuarve apo paraburgosurve.

b. Kufizimet metodologjike

Edhe pse u ndoq një metodologji e standardizuar dhe përfaqësuese, për shkak të numrit të kufizuar të vëzhguesve, monitorimi nuk përfaqëson një mbulim tërësisht kombëtar. Gjithashtu, në IEVP-të e përzgjedhura, kufizimet e hyrjes dhe dinamikat institucionale ndikuan në kohëzgjatjen dhe thellësinë e vëzhgimit.

2. Procesi parazgjedhor

2.1 Publikimi dhe afishimi i listave të zgjedhësve

Publikimi brenda afateve ligjore i listave paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve në vende të dukshme dhe të qasshme për qytetarët mundëson verifikimin e të dhënave të secilit zgjedhës, me qëllim kontrollin e saktësisë së të dhënave duke i garantuar zgjedhësit të drejtën e ankimit në rast të gabimeve apo përjashtimeve të padrejta. Gjithashtu, ato janë komponentë thelbësor të procesit parazgjedhor që ndihmojnë në parandalimin e shkeljeve si votimi i paligjshëm apo dyfishimi i votave.

Sipas nenit 51, pika 4 të Kodit Zgjedhor “*Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre. Publikimi bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun*”. Ndërkohë sipas nenit 56, pika 3 të Kodit Zgjedhor, pasi lista përfundimtare e zgjedhësve i dërgohet nga KZAZ, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-ja, sipas rastit, publikon listën pranë qendrës përkatëse të votimit, në një ambient me akses të lirë për zgjedhësit, si dhe i dërgon KQV-së kopjen e saj të listës për përdorim gjatë votimit.

Nga monitorimi i kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit gjatë periudhës parazgjedhore, u vu re se detyrimet ligjore për publikimin brenda afateve të listës paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve nuk është zbatuar në mënyrë të plotë dhe uniforme në të gjitha qarqet e vendit. Në disa bashki kryesore, përfshirë Durrësin, Shkodrën, Lezhën, Vlorën, Gjirokastrën dhe Elbasanin, procesi i afishimit të listave paraprake ka hasur në vonesa të konsiderueshme ose është bërë në mënyrë të pjesshme dhe jo të qasshme për qytetarët.

Ka pasur raste, vecanërisht në bashkitë e Gjirokastrës, Fierit, Vlorës, Durrësit, Malësisë së Madhe dhe Lezhës, në të cilat listat e votuesve publikoheshin në katet e dyta ose të treta të godinave zyrtare të qytetit, ose në brendësi të zyrave të gjendjes civile.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Posaçërisht, në Gjirokastrë, listat e votuesve afishoheshin në brendësi të hollit të bashkisë së qytetit, ambient i cili ishte i aksesueshëm vetëm gjatë funksionimit të institucionit në orët zyrtare të tij. E njëjta gjë vlen edhe për bashkinë e Fierit, ku listat publikoheshin në ambientet e godinës së Prefekturës, posaçërisht në katet e dyta dhe të treta të institucionit. KShH vëren se nuk ka pasur mekanizma apo funksione të cilat kanë qenë në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara fizike. Në Vlorë, listat nuk janë afishuar në ambjentet e zyrave të gjendjes civile, por janë shpërndarë në ambiente publike, si shkolla, institucione, etj, ku aksesimi për zgjedhësit ka qenë i pamundur përtej orarit zyrtar.

Kjo situatë ka shkaktuar që listat të aksesohen vetëm brenda orarit zyrtar të punës së këtyre institucioneve, duke sjellë pamundësi objektive për aksesimin e tyre në kohën kur qytetaret e mbyllin orarin e punës. Kështu, konsultimi me listat e votuesve ngelet një problematikë e përsëritur edhe në këto zgjedhje, një e metë e cila është theksuar vecanërisht edhe nga raportet e OSBE/ODHIR-it.

Sipas nenit 52, pika 1 të Kodit Zgjedhor, brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të parë të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. I njohur si njoftimi i zgjedhësve në banesë, shpenzimet për këtë proces, sipas pikës 5 të këtij neni², mbulohen nga ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile. Fondi përkatës u shpërndahet njësive të qeverisjes vendore në raport me numrin e zgjedhësve që ka çdo njësi e qeverisjes vendore”.

Nga monitorimi prej vëzhguesve të KShH-së, rezulton se në asnjë prej bashkive të monitoruara gjatë periudhës parazgjedhore, nuk është kryer një alokim transparent, proporcional dhe në përputhje me këtë dispozitë të Kodit Zgjedhor, i fondit përkatës.

Kjo situatë vjen në kundërshtim me gjetjet e mëparshme të monitorimit të KSHH-së si dhe rekomandimet e përsëritura në raportet e OSBE/ODHIR-it.

Në vijim të ndërhyrjeve të realizuara për këtë situatë nga KSHH³, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u është drejtuar të gjitha bashkive të vendit lidhur me detyrimet e afishimit të listave paraprake dhe alokimit të fondit financiar nga Ministria e Brendshme drejt njësive të qeverisjes vendore, me qëllim njoftimin e zgjedhësve⁴.

² Është fjala për mbulimin e shpenzimeve financiare të nevojshme financiare për njoftimin e zgjedhësve në banesa

³ KSHH i është drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me gjetjet për afishimin paraprak të listave të zgjedhësve dhe alokimit të fondit të njoftimit me shkresat 04.04.2025 Nr. 292 Prot., dt. 03.03.2025 Nr. 214 Prot. dhe dt. 24.01.2025 Nr. 95 Prot.

⁴ Shkresa nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me dt. 04.02.2025, Nr. 738 Prot.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Lidhur me këtë situatë, vlerësojmë si të rëndësishëm faktin se neni 171 pika 1 dhe 2 e Kodit Zgjedhor, parashikon se shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor (në të cilat përfshihen edhe detyrimet e personave të ngarkuar me administrimin e procesit zgjedhor), përbën shkelje administrative dhe dënohet me gjobë.

Kjo situatë ka krijuar vështirësi reale për qytetarët që të verifikojnë të dhënat e tyre, duke rritur rrezikun e gabimeve në listat e votuesve, si dhe cenimin e të drejtës për pjesëmarrje efektive në procesin zgjedhor.

KSHH ka theksuar se mungesa e një mekanizmi të qartë dhe të monitoruar për afishimin e listave të zgjedhësve përbën një dobësi serioze në zbatimin e Kodit Zgjedhor. Për të garantuar një proces zgjedhor të lirë dhe të ndershëm, është e domosdoshme që organet e pushtetit vendor të marrin masa për përmirësimin e transparencës dhe aksesit në informacion, duke respektuar plotësisht afatet ligjore dhe duke vendosur listat në vende lehtësisht të aksesueshme për çdo qytetar si dhe duke garantuar në kohë njoftimin e tyre në banesë, me qëllim që të ushtrohet efektivisht e drejta e ankimit.

2.2 Shpërdorimi i administratës publike

Në periudhën parazgjedhore, vëzhguesit e KSHH-së dhe të organizatave të tjera partnere kanë konstatuar disa raste të diskutueshme të shkeljeve të legjislacionit zgjedhor të ndalimeve të shpërdorimit të aseteve publike për qëllime zgjedhore, të cilat i janë përcjellë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe më tej ankimuar në disa raste në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

KSHH vëren se institucionet publike kanë përdorur artifica ligjore për t'ju shmangur fushës së veprimt të kufizimeve të vendosura në dispozitat e Kodit Zgjedhor. Në disa raste, interpretimi i KQZ-së lidhur me këto kufizime është i një natyre të ngushtë (*stricto sensu*) që shkon përkundrajt frymës së ligjit për një garë të barabartë e të ndershme midis partive politike. Gjithashtu, ne kemi mendimin se në raste të diskutueshme, do të kishte qenë i nevojshëm një hetim administrativ më i plotë dhe i gjithëanshëm nga KQZ, për të konstatuar shpërdorimin ose jo të aseteve publike në avantazh të mazhorancës qeverisëse.

Vijon të mbetet një nga rastet tipike të shpërdorimit të burimeve publike, përdorimi i rrjeteve sociale të institucioneve publike për të shpërndarë aktivitetet dhe programet politike të kandidatëve për deputetë. Sipas një vendimi precedent nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i dhënë në zgjedhjet e fundit të qeverisjes vendore të 14 majit 2023, rrjetet sociale të institucioneve të administratës shtetërore do të konsiderohen si “burime publike”, mbi të cilat do të rëndojnë të gjitha rregullimet ligjore që lidhen dhe me asete të luajtshme ose të paluajtshme në administrim shtetëror, referuar nga neni 91 pika 1 e Kodit Zgjedhor. Por në ndryshim nga ky vendim, në këto zgjedhje parlamentare, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka ndjekur një metodë interpretimi jo koherente, për sa i takon dispozitave përkatëse të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, duke treguar një “tolerancë”, ndonjëherë edhe të paarsyetuar mjaftueshëm, për gabimet njerëzore



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të personave që menaxhojnë këto profile në rrjetet sociale. Shpeshherë, menaxherët e rrjeteve sociale të institucioneve publike, administrojnë edhe profilet publike të kandidatëve në fjalë, çka përbën konflikt interesi që sjell shpërdorim të aseteve publike, duke krijuar disavantazh në garën elektorale.

Në Janar të 2025-ës, pak ditë para se të fillonte afati për këtë ndalim ligjor, Këshilli i Ministrave miratoi me vendim dhënien e një bonusi (shpërblimi) të pranverës për pensionistët⁵. Ky vendim ka dhënë efektet në Mars të vitit 2025, pra brenda periudhës së ndaluar, të parashikuar në dispozitën e mësipërme. Në këto kushte, Qeveria vlerësojmë se ka përdorur një aritificë ligjore për t'ju shmangur efekteve të ndalimeve ligjore të nenit 91 të Kodit Zgjedhor që përdor togfjalëshin “propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore” në periudhën katër mujore dhe nuk përfshin efektet e zbatimit të tyre. Për rrjedhojë të këtij precedenti, do të ishte e nevojshme rishikimi ligjor i kësaj dispozite të Kodit Zgjedhor, pasi ky bonus në vetvete, edhe pse jo i ndaluar formalisht nga Kodi Zgjedhor krijoi në thelb në këto zgjedhje parlamentare, një avantazh të padrejtë për mazhorancën qeverisëse, në shpërdorim të aseteve publike.

Vëzhguesit e KSHH-së kanë konstatuar raste të vazhdueshme të hapjes së thirrjeve për projekte apo mbështetje financiare nga bashki të caktuara, për mbështetjen e modeleve të gjelbra të biznesit dhe veprimtarive të tjera kulturore. Raste të tjera të raportuara përfshijnë thirrjen për aplikime në Programin Social të Strehimit për Subvencionimin e Interesave të Kredisë (nga Bashkia Lezhë), thirrjen për subvencionimin e familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti dy muaj para ditës së votimit (Bashkia Tiranë), etj. Në thelb, këto thirrje interpretohen në fushën e veprimit të togfjalëshit “mbështetje ekonomike/sociale” të parashikuara nga neni 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor. Këto thirrje janë hapur ose përpara afatit të ndaluar katër mujor nga dita e votimit dhe shqyrtimi i aplikimeve dhe vendimmarrja për shpalljen e fituesve është parashikuar brenda kësaj periudhe ose rezultojnë se janë hapur gjatë kësaj periudhe ndalimi.

Vlen të theksohet se paligjshmëria e këtyre aktiviteteve nuk qëndron në kauzën apo qëllimin e tyre, por në afatin e ngushtë në të cilën është hapur thirrja për aplikime dhe përdorimit të mundshëm të padrejtë të burimeve publike për të krijuar një “klime detyrimi apo ndikimi” tek subjektet përfituese të subvencionimit.

Bazuar në sinjalizimet e vëzhguesve të tij, KSHH ka përcjellë pranë KQZ-së, rastin e përdorimit nga Partia Socialiste e Shqipërisë për zyrën e saj elektorale në qytetin e Elbasanit, të një godine e cila ka qenë në administrim shtetëror. Nga Bashkia Elbasan është vënë në dispozicion Vendimi i Këshillit Bashkiak të Elbasanit i datës 31.08.2021 që miraton dhënien në përdorim pa kundërshtim të ambjentit “ish Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, Partisë Socialiste

⁵ <https://shqiptarja.com/lajm/mbledhja-e-qeverise-ministri-ervin-hoxha-miratohet-shperblimi-per-punonjesit-e-policise-dhenia-e-shperblimeve-do-unifikohet>



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

dega Elbasan, bazuar në nenet 22 dhe 22/1 të ligjit Nr 8580 dt. 17.03.2020 “Për Partitë Politike”⁶. Sipas nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor, “*Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, ...*”. Konkretisht, përjashtimi parashikohet në nenin 22/1 të ligjit Nr. 8580 “Për partitë politike”, i cili vendos si procedurë të rregullt lidhjen e kontratave të huapërdorjes midis subjekteve politike dhe bashkive përkatëse, kontrata, të cilat sipas nenit 901 të Kodit Civil, janë kontrata pa kundërshtpërblim. Duke pasur parasysh kontekstin politik shqiptar dhe rastet e mëparshme të shpërdorimit të administratës publike, vërejmë se një shtrat i tillë ligjor krijon baza për vendosjen e burimeve publike në favor të mazhorancës qeverisëse (e cila drejton dhe qeverisjen vendore në këtë Bashki). Gjithashtu, si ligji “Për Partitë Politike” dhe VKM-ja përkatëse nuk përcaktojnë një afat maksimal për zgjatjen e kontratës së huapërdorjes që mund të lidhet në këto raste, duke krijuar premisa për shpërdorim të burimeve publike për qëllime politike në periudhat zgjedhore.

Një rast tjetër është përcjellë në KQZ, sërisht në Bashkinë Elbasan, ku vëzhguesi i KSHH-së ka raportuar se në godinën e ish-Kinema “Vullnetari (Qendra Rinore pranë Universitetit Aleksandër Xhuvani, Godina Kryesore), ndërtesë e cila është në administrim shtetëror, është zhvilluar një takim elektorale më datë 15 janar 2025, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë dhe përfaqësuesve të tjerë të Partisë Socialiste. Vënia në dispozicion e këtij ambienti Partisë Socialiste është përsëritur edhe në datën 18.03.2025, rasti i cili është përcjellë KQZ-së nga KShH. Për të njëjtën bashki, janë përcjellë raste, ku individë me poste të larta drejtuese, gjatë orarit zyrtar të punës, kanë shpërndarë në rrjetet e tyre sociale poste propaganduese të kandidatëve politikë të partisë në pushtet. Nga Bashkia Elbasan është pretenduar se ambiente të tilla kulturore sportive në administrim shtetëror mund t’u jepen për përdorim subjekteve të ndryshme, mjaft që të mos cenohet veprimtaria rutimore e institucionit përkatës si dhe aktiviteti të mos zhvillohet në orarin zyrtar. Në këtë rast, KShH ka argumentuar se bazuar në nenin 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor, përveç rasteve përjashtimore të parashikuara me ligj, godina në administrim shtetëror nuk mund të vendosen në dispozicion të subjekteve politike për zhvillimin e aktiviteteve elektorale, qoftë edhe jashtë orarit zyrtar.

Sërisht në Bashkinë Elbasan është konstatuar se zyra elektorale e një kandidateje të Partisë Socialiste është vendosur ngjitur dhe në të njëjtën adresë, me godinën e ish-kinema “Vullnetari”, Qendra Rinore, pranë Universitetit Aleksandër Xhuvani, Godina Kryesore, ambient i cili ka shërbyer për vendosje Qendre Votimi, situatë kjo e cila është në kundërshtim flagrant me nenin 93 pika 2, gërma “b” e Kodit Zgjedhor, e cila parashikon se “*Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore*”.

Ndërkohë, nga aktiviteti monitorues i KSHH-së, janë konstatuar disa raste për dhënien e ndihmës ekonomike familjeve në nevojë, të cilat janë përcjellë pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

⁶ Ku saktësohet se për pajisjen me ndërtesë për selinë vendore, partitë politike duhet t’i bëjnë një kërkesë Kryetarit të Bashkisë, në mënyrë që të lidhet një kontratë huapërdorje për ndërtesa të lira.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KSHH ka argumentuar se thirrja e njoftimit të dates 04.03.2025 nga Bashkia Durrës, me të njëjtin objekt⁷, ngre indicie për veprimtari të kundërligjshme me nenin 91 të Kodit Zgjedhor, në rast se individët përfitues të kësaj thirrjeje nuk i plotësonin kriteret e posaçme nënligjore për të qenë përfitues. KQZ nuk ka ndërmarrë një hetim administrativ të plotë dhe të gjithëanshëm nëse këto kushte plotësohen apo jo. E themi këtë pasi në të kaluarën, dhënie e ndihmës ekonomike është përdorur si mjet për të nxitur përfituesit e saj për të votuar në favor të mazhorancës qeverisëse, në nivel qendror dhe/ose vendor.

Vëzhguesit e KSHH-së kanë konstatuar se hapja e thirrjes për aplikime nga Bashkia Tiranë për mbështetje financiare bizneseve të mbështetura në mekanizma ekologjikisht të sigurta (*environmentally friendly*) me datë 01.03.2023 dhe afat deri më 31.03.2025, ka elementë të një veprimtarie të ndaluar sipas nenit 91 pika 4 e Kodit Zgjedhor. Kjo duke marrë parasysh zhvillimin e thirrjes brenda 4 muajve nga dita e votimit të zgjedhjeve parlamentare të dt.11 Maj 2025 si dhe natyrës mbështetëse ekonomike/ sociale, që i takon kësaj thirrjeje për aplikime. Përkundrejt parashtrimeve të Bashkisë Tiranë, KSHH ka argumentar se as në Vendimin nr.131, datë 18.13.2024, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025 - 2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2025”⁸, as në Udhëzuesin Operacional për Zbatimin e Projektit, as në Vendimin nr. 167, datë 18.13.2020, të Këshillit Bashkiak⁹ nuk ka parashikime të afateve kaq të afërta të aplikimit me ditën e votimit. Në datë 11.04.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi mosfillimin e procedimit administrativ, me arsyetimin se fondet për thirrjen për projekte me objektin e sipërpërmendur janë vendosur në dispozicion përpara periudhës katër mujore të sipërcituar, posaçërisht më 18.12.2024. Më tej, kjo thirrje ka qenë e përfshirë në ligjin për buxhetin e vitit 2025¹⁰.

Në vijim të këtij rasti, mendojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhej të kishte realizuar një interpretim më të gjerë të ligjit, duke pasur parasysh frymën e tij, bazuar në faktin se përpos vënies në dispozicion të fondeve financiare më pare periudhës 4 mujore, shqyrtimi i aplikimeve dhe fituesve të kësaj thirrjeje do të bëhej pikërisht brenda këtij harku kohor.

Sistemi i patronazhimit është raportuar nga korrespondentët dhe vëzhguesit e KSHH-së edhe në këto zgjedhje, edhe pse format në të cilat realizohet ai janë të sofistikuara dhe vështirësojnë identifikimin në terma konkret nga aktorë të jashtëm edhe të pavarur. Në këtë drejtim, shqetësues është angazhimi

⁷ Njoftim për Rendin e Ditës nga Këshilli Bashkiak, me pikë të parë miratimin e projektvendimit “Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri 6% dhe fondi i të ardhurave të bashkisë durrës, për muajin shkurt 2025”

⁸ Nëpërmjet të cilit është miratuar fondi i parashkuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë, në vlerën 18.000.000 lekë, për zbatimin e këtij projekti për vitin 2025.

⁹ “Për miratimin e projektit “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja “të gjelbërta” të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta” duke futur elementë gogreen në to”

¹⁰ Vendimi nuk është i gjendshëm në faqen zyrtare të KQZ-së, por seanca përkatëse gjendet në këtë link:
<https://www.youtube.com/watch?v=MyQ1tss6U0M>



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

i nëpunësve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, në mbështetje të kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore, të organizuar sipas lagjeve apo njërive të caktuara. Për shkak të marrëdhënieve të tyre të varësisë, funksionit dhe detyrës që ata kryejnë, ekziston rreziku që në shpërdorim të saj, të krijohet një klimë nxitëse ose intimiduese ndaj zgjedhësve që preken drejtpërsëdrejti apo tërthorazi nga detyra dhe funksioni i tyre. Për rrjedhojë, legjislacioni ynë zgjedhor ka nevojë të rishikohet, duke garantuar lirinë e shprehjes dhe organizimit (sikurse është e drejta e npunësit për të marrë pjesë në një tubim elektorale) por njëkohësisht duke vendosur kufizime proporcionale që shmangin abuzimet me detyrën nga nëpunësit publik që koordinojnë apo mbikqyrin fushatën zgjedhore duke ushtruar ndikim tek zgjedhësit për të favorizuar forcën politike në pushtet, apo edhe forca të tjera politike.

2.3 Ngritja e kuadrit nënligjor dhe rregullator nga KQZ

Në veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për hartimin, përditësimin dhe ngritjen e kuadrit rregullator dhe nënligjor për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, KSHH ka ofruar kontributin e tij modest dhe të vazhdueshëm për sa i takon këtyre akteve, duke nxjerrë në pah dobishmërinë, përparësitë dhe hapësirat e nevojshme për përmirësim. KSHH vlerëson konsultimin e vazhdueshëm të KQZ-së lidhur me këto projekt-akte, por nënvizon të njëjtin konkluzion si në zgjedhjet e kaluara se afatet e konsultimit janë shumë të ngushta. Ato variojnë 2 – 3 ditë, në disa raste duke përfshirë edhe ditët e pushimit apo të festave zyrtare. Vihet re një mungesë reagimi nga KQZ për komentet dhe sugjerimet e dhëna nga KSHH dhe ndikimin që ato kanë patur në procesin vendimmarrës, pra nëse i kanë shërbyer ose jo përmirësimit të projekt-aktit.

KSHH ka dhënë mendime dhe sugjerime për përmirësimin e projekt-vendimeve të KQZ-së për miratimin apo ndryshimin e rregullave për të mundësuar ushtrimin e të drejtës së votës nga zgjedhësit që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike. Konkretisht, disa nga sugjerimet dhe komentet tona më të rëndësishme për këto projekt-akte parashtrihen në vijimësi të këtij raporti.

Për sa i takon Programit për Ndërgjegjësimin e Votuesve që u përkasin pakicave kombëtare, KSHH është shprehur se takimi i drejtpërdrejtë me këtë kategori votuesish përbën një hap pozitiv, por sidoqoftë duhej të ishte shtrirë në të gjithë hapat e procesit zgjedhor. KSHH ka vlerësuar domosdoshmërinë e ngritjes së një ekipi trajnuesish për personat të cilët do të zhvillonin takimet me votuesit e pakicave kombëtare.

Në lidhje me Projekt Vendimin “ Për Miratimin e Rregullave për Regjistrimin e Zgjedhjeve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, KSHH është shprehur se lista e dokumentacionit e kërkuar për realizimin e së drejtës së votës për shtetasit shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit është tejet e madhe, duke u bërë jo vetëm joefektive, por edhe e perealizueshme. Kjo ka kontribuar në burokratizimin e procesit, duke e vështirësuar më shumë votën e emigrantëve.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KSHH ka vlerësuar pozitivisht projekt vendimin e KQZ-së, “Për një shtesë në Vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, duke theksuar rëndësinë e saj për përmirësimin e saktësisë dhe transparencës në procesin e regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë vendit. Sipas këtij mekanizmi, KQZ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) koordinohen në kohë reale për azhurnimin e regjistrit kombëtar të zgjedhësve dhe shmangien e gabimeve njerëzore. Një aspekt thelbësor i këtij ndryshimi është transparenca e garantuar përmes publikimit të një ekstrakti të listave të regjistrimit, duke ofruar akses për qytetarët, partitë politike dhe organizatat monitoruese. Megjithatë, KSHH vuri në dukje se zbatimi i këtij mekanizmi kërkon masa të forta sigurie për mbrojtjen e të dhënave personale dhe një infrastrukturë teknologjike të qëndrueshme.

Lidhur me projekt-vendimin e KQZ-së “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”, në sugjerimet dhe mendimet e dhëna për të, KSHH nënvizoi disa çështje kryesore që lidhen me qartësinë ligjore, përkufizimet institucionale, si dhe masat organizative për zbatimin efektiv të rregullave. Gjithashtu, u sugjerua që vendimi të përcaktojë më qartë konceptet e “veprimtarisë së ndaluar” dhe “keqpërdorimit të aseteve publike”, duke i bërë ato të lehta për t'u interpretuar dhe zbatuar në praktikë. Një tjetër propozim është përfshirja e një mekanizmi të detajuar për raportimin dhe shqyrtimin e shkeljeve brenda një afati të shkurtër, me mundësinë e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie.

Lidhur me projekt-vendimin e KQZ-së, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”, KSHH ka theksuar nevojën për përmirësime që mundësojnë një proces të sigurt dhe transparent. Konkretisht janë evidentuar se disa përjashtime në lidhje me dorëzimin e dokumenteve për regjistrimin e zgjedhësve shqiptarë jashtë vendit dhe lejimi i palëve të treta (anëtarë familje ose persona që banojnë në të njëjtën adresë) që të ngarkojnë dokumentet, mund të krijojnë pasiguri juridike dhe rrezik për abuzime, duke qenë se vendimi fillestar kërkonte që vetë zgjedhësi të dorëzonte dokumentacionin. Problemet përfshijnë mungesën e një mekanizmi të fortë verifikimi dhe pasigurinë në lidhje me autoritetet që duhet të verifikojnë deklaratat e bashkëjetuesve. Gjithashtu, KSHH ka sugjeruar se është e nevojshme të forcohet mbrojtja e të dhënave personale dhe të përcaktohen qartë autoritetet përgjegjëse, për të lëshuar dhe verifikuar dokumentet e adresës.

Lidhur me projekt-vendimin e KQZ-së, “Për një shtesë në Vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, KSHH shprehu shqetësimin se këto ndryshime reflektojnë amendamentet në Kodin Zgjedhor të cilat u rrëzuan me vota të shumicës në Parlament. KSHH rekomandon që KQZ-ja, si një organ i pavarur, nuk duhet të ndikohet nga interesat politike; ndryshimet në rregulloret e saj për të anashkaluar procesin ligjor dhe parlamentar minojnë këtë



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

pavarësi dhe krijojnë precedent negativ. Politizimi i KQZ-së cenon besimin në integritetin e procesit zgjedhor. Propozimi për përdorimin e dokumenteve të identifikimit biometrik brenda afatit të vlefshmërisë nga vende të ndryshme të huaja për të ushtruar të drejtën e votës së shtetasve nga jashtë vendit mund të çojë në probleme me besueshmërinë e procesit zgjedhor. Gjithashtu, është thelbësore që autoritetet të ndërmarrin procedura verifikimi të sakta të këtyre dokumenteve dhe të mbajnë një bashkëpunim efektiv me autoritetet e huaja për të garantuar integritetin e zgjedhjeve.

3. Heshtja Zgjedhore

Heshtja zgjedhore është një komponent thelbësor i procesit zgjedhor, i përcaktuar në mënyrë të qartë në **nenin 77 të Kodit Zgjedhor** të Republikës së Shqipërisë. Ajo nënkupton periudhën kur ndalohet çdo fushatë dhe propagandë zgjedhore, me qëllim që qytetarët të kenë një ambient të qetë për të reflektuar dhe për të marrë një vendim të lirë një ditë para dhe gjatë ditës së votimit, pa presione apo ndikime të papërshtatshme.

KSHH realizoi një monitorim të pjesshëm të periudhës së heshtjes zgjedhore, një ditë para ditës së votimit, më 10 maj 2025. Monitorimi u realizua nga vëzhguesit e KSHH-së në terren dhe nëpërmjet monitorimit të mediave sociale dhe tradicionale.

Në përgjithësi, periudha e heshtjes u përmbajt në shumë zona, por në rreth 25% të rasteve u evidentuan shkelje të drejtpërdrejta dhe të qarta të ndalimit.

Shpërndarje e materialeve propagandistike (billboards, fletushka, afishe, broshura) pranë institucioneve publike, shkollave dhe afër qendrave të votimit u vunë re në zona specifike si në bashkitë Tiranë¹¹, Fier¹², Vlorë¹³ & Malësi e Madhe¹⁴.

Aktivitetet në rrjetet sociale dhe platformat digjitale: Kandidatë dhe përfaqësues politikë të dy forcave kryesore politike vazhduan të publikojnë postime me natyrë elektorale dhe thirrje për mbështetje, duke sfiduar ndalimin e heshtjes zgjedhore dhe duke shkelur në këtë mënyrë ligjin në fuqi. Këtu, vëzhguesit e Komitetit Shqiptar të Helsinkit kanë konstatuar edhe promovime të ngjarjeve, shërbimeve apo objekteve publike nëpërmjet deklaratave, postimeve, apo *reels-ave* nëpër rrjete sociale, duke shkaktuar kështu një formë indirekte të shkeljes së heshtjes zgjedhore.

Roli i mediave tradicionale dhe lokale: Për aq sa mund të verifikohej nga vëzhguesit, është pozitiv fakti se mediat lokale dhe kombëtare u treguan të përgjegjshme, duke respektuar në mënyrë

¹¹ Rruga Vaso Pasha, ngjitur me Bankën Kombëtare Tregtare; Rruga, “Ismail Qemali”, përballë me Bankën “Credins”; Bulevardi Zogu I

¹² Lagja “11 Janari”, Rruga “Ramiz Aramasi”

¹³ Sheshi “Tre Racat”, përballë teatrit “Petro Marko”, rrethrotullimi i Skelës

¹⁴ njësia administrative Koplik, në afërsi të godinës së Bashkisë



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

rigoroze periudhën e heshtjes zgjedhore, pa transmetuar përmbajtje propagandistike apo fushatë gjatë ditës së ndalimit.

Sipas nenit 174 të Kodit Zgjedhor, thyerja e heshtjes zgjedhore nga subjektet zgjedhore gjohet nga KQZ-ja me 500,000 Lek. KSHH iu drejtua, në dt. 10 Maj 2025 me shkresë KQZ-së për rastet e konstatuara të cenimit të heshtjes zgjedhore, duke kërkuar heqjen e materialeve propagandistike në një rreze prej 150 metrash nga Qendrat e Votimit, prej Komisioneve të Qendrave të Votimit, si dhe heqjen e materialeve propagandistike në distanca edhe më të largëta se ajo e sipërpërmendura, nga ana e Policisë së Shtetit dhe/ose Policisë Bashkiake. Megjithatë, nuk pati një reagim institucional lidhur me këtë ndërhyrje.

4. Procesi i Dorëzimit dhe Shpërndarjes së Materialeve Zgjedhore

Shpërndarja dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore janë faza të rëndësishme për garantimin e një procesi transparent dhe të rregullt të votimit. Ky proces përfshin disa hapa:

- KQZ ka përgjegjësinë për përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve në nivel qendror dhe më pas dërgimin e tyre tek Komisionet Zonale (KZAZ).
- Komisionet Zonale janë përgjegjëse për shpërndarjen e materialeve tek qendrat e votimit (QV) në territorin e tyre.

Gjetjet e monitorimit të pjesshëm nga KSHH për këtë fazë janë:

- Shpërndarja e materialeve zgjedhore nga KQZ-ja tek KZAZ-të u realizua në kohë dhe në përputhje me afatet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Kjo tregon një planifikim dhe organizim të mirë në nivel qendror.
- Problematikat u vërejtën nga vëzhguesit gjatë kalimit të materialeve nga KZAZ-të tek QV-të, ku u evidentuan vonesa serioze dhe mangësi në koordinim, në cenim të nenit 100 të Kodit Zgjedhor, i cili kërkon që materialet të jenë të dorëzuara së paku 15 orë para fillimit të votimit.
- Në disa qendra votimi, shpërndarja e materialeve u bë deri në orët e vona të datës 10 maj 2025, duke rrezikuar fillimin e procesit të votimit në kohë dhe duke shkaktuar shqetësime midis anëtarëve të komisioneve.

Shkaqet kryesore të këtyre problemeve sipas konstatimeve tona në terren ishin:

- Mungesa dhe ndryshimet e shpeshta në përbërjen e anëtarëve të KQV-ve, të cilat krijuan vështirësi në organizimin dhe përgjegjësitë operative në terren.
- Mungesa e mjeteve të transportit dhe infrastruktura e pamjaftueshme logjistike që e bënin të vështirë transportin dhe shpërndarjen e materialeve në kohë dhe në mënyrë të sigurt drejt QV-ve.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- Koordinimi i dobët ndërmjet KZAZ-ve dhe QV-ve, si dhe mungesa e komunikimit efektiv gjatë periudhës së dorëzimit të materialeve.

Megjithatë, një element pozitiv është fakti që në **95.7% të rasteve, procesi i dorëzimit të materialeve u dokumentua me procesverbale të veçanta** që mundëson një nivel të lartë transparence dhe gjurmueshmërie për çdo veprim të kryer gjatë këtij procesi.

5. Monitorimi i ditës së Votimit

Gjatë ditës së votimit më 11 maj 2025, KSHH realizoi një monitorim të pjesshëm në mbi 145 Qendra Votimi (QV) të shpërndara në 13 bashki të ndryshme të vendit, duke përfshirë zona urbane dhe rurale, si dhe tre qendra të posaçme në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP 302, IEVP 313, IEVP Durrës). Ky monitorim kishte për qëllim vlerësimin e zbatimit të ligjit zgjedhor dhe garantimin e një procesi sa më të lirë dhe të drejtë për të gjithë qytetarët që ushtrojnë të drejtën e votës.

Gjatë ditës u identifikuan një numër problematikash që kërkojnë adresim të menjëhershëm për të garantuar zbatimin rigoroz të legjislacionit zgjedhor në zgjedhjet e ardhshme.

a. Hapja dhe fillimi i procesit të votimit

Bazuar në nenin 11 pika 1 të Kodit Zgjedhor, procesi i votimit duhej të fillonte në orën 7:00, të datës 11 Maj 2025. Fillimisht, faza e përgatitjes dhe hapjes së QV-ve u realizua kryesisht në mënyrë të rregullt dhe sipas afateve ligjore. Megjithatë, u vunë re vështirësi teknike dhe organizative që ndikonin në procesin e votimit, si mungesa e energjië elektrike¹⁵.

Në një rast, procesi i hapjes së Qendrës së Votimit u vonua aq shumë, sa votuesit iu desh të largohej, për kryerjen e angazhimeve të tjera të ditës¹⁶. Për më tepër, mungesa e anëtarëve të komisioneve të votimit ishte një problem i përsëritur në disa QV, duke sjellë vonesa në nisjen e procesit dhe duke ulur efikasitetin e organizimit¹⁷. Në disa raste, vonesat në hapjen e QV-së tejkaluan kufijtë ligjorë, duke shkaktuar grumbullime dhe flukse të mëdha zgjedhësish në orët e para të mëngjesit, veçanërisht në zonat urbane¹⁸.

b. Prania e personave të paautorizuar gjatë ditës së votimit

¹⁵ Në QV 3362 (Bashkia Korçë), energjia elektrike ka munguar deri në minutat e fundit para hapjes së saj, situatë e cila krijoi vonesa në procesin e hapjes së votimit, gjë e cila pasoi në rradhë të gjata votuesish që në orët e para të mëngjesit.

¹⁶ QV 4235/01 (Bashkia Gjirokastrë)

¹⁷ QV 4235, QV 4439/1 (Bashkia Vlorë), QV 0729/00 (Bashkia Lezhë),

¹⁸ QV 113500 & 113501 (Bashkia Dibër), QV 4493 (Bashkia Vlorë), QV 3289 (Bashkia Berat)



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Fenomeni i prezencës së personave të paautorizuar në QV dhe perimetrin e brendshëm të tyre deri 150 m, vijon të jetë shqetësues, i përsëritur dhe i konstatuar edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare.

Vëzhguesit e KSHH-së kanë konstatuar raste shqetësuese të pranishme të personave të paautorizuar në QV të caktuara, vëzhgues partiakë të cilët udhëzonin zgjedhësit, përdorimin e “listave verifikuese” nga këta të fundit dhe në disa raste, nga anëtarë të KQV-ve, si dhe një rast tejet shqetësues të pranishme të personave të armatosur pranë një QV-je në Durrës.

Në disa qendra votimi në qytetin e Durrësit¹⁹, vëzhguesit konstatuan angazhimin e aktivistëve partiakë në procedurat e verifikimit dhe orientimit të votuesve, një praktikë që bie ndesh me Kodin Zgjedhor dhe që rrezikon të ndikojë në vullnetin e lirë të zgjedhësve e për rrjedhojë në integritetin e procesit zgjedhor.

Gjithashtu, u evidentuan raste ku persona pa bexhe akreditimi qëndronin në afërsi të QV-ve, por jashtë perimetrit prej 150 metrash dhe kqyrnin personat që futeshin dhe dilnin nga QV-të, megjithëse nuk u dokumentua presion i drejtpërdrejtë ndaj votuesve. Kjo situatë krijon një atmosferë të pasigurtë, mbart premisa për presion për zgjedhësit dhe cenon besimin në proces.

c. Rregullshmëria e procedurave të votimit

Anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) kryen shumicën e detyrave të tyre ligjore në përputhje me nenin 110 të Kodit Zgjedhor, por u regjistruan edhe disa raste vonesh, keqkuptimesh procedurale dhe mungesë koordinimi. Kjo u pasqyrua veçanërisht në përdorimin e pajisjeve PEI²⁰, të cilat funksionuan vetëm pjesërisht, duke detyruar përdorimin e metodave manuale për identifikimin e votuesve në disa raste. Më tej, përdorimi dhe funksionimi i këtyre pajisjeve shënon një trend përmirësues në raport me zgjedhjet e fundit vendore, çka tregon një nivel më të mirë të menaxhimit nga KQZ.

Në disa raste mungesa e një ose dy komisionerëve shkaktoi vakanca dhe pezullim të procesit pa arsye të qarta ligjore, si rezultat i mosmarrëveshjeve mbi rolin dhe figurën e sekretarit të KQV-së, gjë që krijoi tension dhe konfuzion në ambientet e votimit²¹. Po ashtu, largimi i paarsyeshëm dhe i pakontrolluar i anëtarëve të komisioneve gjatë ditës së votimit u shënuar në mënyrë të përsëritur

¹⁹ QV1429/2, QV 1449, 1449/1, 1450, 1452/1, 1452/2

²⁰ QV 3280 (Bashkia Berat).

²¹ Në QV 4242/1, ka pasur kundërshtime nga një pjesë e anëtarëve të KQV-së lidhur me ushtrimin e funksionit të sekretares nga një person i punësuar në Bashkinë e Qytetit. Megjithatë ushtrimi i detyrave administrative në organet e administratës publike, nuk prashikohet shprehimisht nga Kodi Zgjedhor si një shkak papajtueshmërie me detyrën e sekretarit, KZAZ përkatëse ka vendosur zëvendësimin e sekretares, me një vëzhguese partiake që ishte prezente në atë QV.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

në disa qendra votimi²², çka dëmton stabilitetin dhe funksionimin e komisioneve përgjatë gjithë procesit.

d. Identifikimi me Pajisjen PEI

Sipas nenit 105/1, gërmat “c” dhe “ç” të Kodit Zgjedhor, kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë, më tej zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij. Vëzhguesit e KSHH-së kanë raportuar se “heqja e vizës” së emrit të zgjedhësit në listë dhe “marrja e nënshkrimit” përbri emrit të tij/saj nuk është realizuar në rastet kur është përdorur pajisja PEI. Kjo praktikë u vërejt pothuasje në të gjitha QV-të e monitoruara nga vëzhguesit e KSHH-së. Në raste përjashtimore si në QV 1140/00 (Bashkia Dibër), vëzhguesit e KSHH kanë raportuar se paralelisht me funksionimin normal të pajisjes PEI, vëzhguesit nënshkruanin fizikisht në listën e zgjedhësve, të mbajtur nga KQV-të.

KSHH vëren se këto garanci procedurale të Kodit Zgjedhor nuk janë respektuar si rrjedhojë e programit të temave të trajnimit “Për operatorët e pajisjes elektronike të identifikimit (PEI, Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit, Sektori i Zhvillimeve Digjitale manualeve orientues të KQZ-së) apo si rrjedhojë e orientimeve të dhëna nga përfaqësuesit e KQZ-së drejt Komisionerëve, gjatë procesit të votimit. KSHH vlerëson se materialet me natyrë trajnuese apo orientuese të KQZ-së nuk duhet të tejkalojnë garancitë procedurale të ofruara nga ligji. Për ta lehtësuar këtë process në të ardhmen është e nevojshme që dispozita e nenit 105/1, gërma “c” e Kodit Zgjedhor të rishikohet, me qëllim që të mos merret nënshkrimi i zgjedhësve kur funksionon pajisja PEI.

e. Respektimi i fshetësisë së votës

Praktika e verifikimit të identitetit të zgjedhësve me anë të numrave të tyre rendorë, prej vëzhguesve partiakë të pranishëm në QV vijon të jetë një problematikë e përsëritur, në disa raste është konstatuar të ndiqej me lista të printuara ose aplikacione të veçanta. Kështu, në QV 1135/00 në Dibër, vëzhguesi i partisë socialiste qëndronte në kundërshtim me pozicionimin që kanë vëzhguesit partiak në QV, prapa anëtarëve të KQV për të verifikuar zgjedhësit që votojnë. Kjo praktikë përbën një shkelje serioze të votës së lirë, pasi veprimet e tilla mund të krijojnë presion ose ndikim të padrejtë mbi votuesit. Kjo praktikë, sikurse është theksuar më herët mbart premisa për influencat ndaj zgjedhësve që rezultojnë në listat partiake të subjekteve zgjedhorë dhe dëmton fshehtësinë e votës.

f. Ndihma ndaj zgjedhësve që nuk votojnë dot vetë

²² QV 4235, 4238, 4239/1 (Bashkia Gjirokastrë), QV 1841 (Bashkia Tiranë),



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Sipas nenit 108 të Kodit Zgjedhor, zgjedhësit, që për arsye fizike nuk janë në gjendje të kryejnë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojnë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të QV-së. Para se të shënojë në fletën e votimit, zgjedhësi “ndihmës” bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.

Për këtë aspekt të monitoruar, vëzhguesit e KSHH-së kanë konstatuar, në disa raste ndjekjen e një praktike jo në respektim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Kështu, në QV 1969²³, një zgjedhës i cili nuk ka mundur të votojë dot vetë, për arsye të pamundësisë fizike, është ndihmuar nga Komisioni i Qendrës së Votimit. Paragrafi i parë i nenit 118 të Kodit Zgjedhor shprehet specifikisht për ndihmën e ofruar nga zgjedhësit e tjerë dhe jo anëtarët e KQV-së. Në një rast në QV 3271²⁴, një votuese në pamundësi fizike për të votuar vetë është ndihmuar nga i biri i saj, por pa u shoqëruar me mbajtjen e dokumentacionit shoqërues sipas nenit 108 të Kodit Zgjedhor.

g. Votimi familjar

Në disa QV në Korçë²⁵, Vlorë²⁶, Berat²⁷ dhe Durrës²⁸ u raportuan incidente të votimit familjar, ku votimi kryhej me ndihmën e anëtarëve të familjes në kundërshtim me kërkesat e ligjit, si dhe raste ofrimi të ndihmës nga anëtarë apo kryetarë të KQV-ve ndaj disa votuesve²⁹, çka mund të nënkuptojë presion ose ndikim mbi zgjedhjen e lirë të votës.

h. Fotografimi i votës

Në përgjithësi, monitorimet e kryera nga vëzhguesit e KSHH-së nuk kanë treguar problematika të shpeshta me fotografimin e votës, nisur kjo nga edhe nga përvoja dhe sugjerimet e dhëna me zgjedhjet e kaluara. Megjithatë, në QV 1921/01³⁰, anëtarët e KQV-së nuk kanë kryer një verifikim të plotë nëse një votues i futur në dhomën e fshehtë, kishte aparatin celular me vete apo jo. Kështu, gjatë procesit të votimit, është dëgjuar një zhurmë e shkrepjes së kamerës nga aparati celular (një rast i ngjashëm edhe me atë të reflektuar në raportin e zgjedhjeve të kaluara), gjë e cila ka shkaktuar diskutime mes anëtarëve të Komisionit.

i. Monitorimi i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

²³ Bashkia Tiranë

²⁴ Bashkia Berat

²⁵ QV 3651

²⁶ QV 443800

²⁷ QV 3272/01

²⁸ QV 1420/4

²⁹ QV 1969

³⁰ Bashkia Elbasan



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Vëzhguesit monitoruan QV e ngritura në IEVP-të “Mine Peza” dhe “Jordan Misja” në Tiranë, si dhe IEVP Durrës.

Gjatë këtij monitorimi, u vërtetua se në IEVP nr. 313 në Tiranë pati ankesa nga të dënuarit për mungesën e kartave të identitetit, çka pamundësoi ushtrimin e së drejtës së votës për disa prej tyre. Për më tepër, në këtë institucion u raportuan raste ku disa të dënuar u përpoqën të orientojnë njëri-tjetrin për mënyrën e votimit, duke krijuar një formë ndikimi që cenon lirinë dhe fshehtësinë e votës.

Në IEVP Durrës, ku qendra e votimit ishte vendosur në ambientet e xhamisë së institucionit, u vërejt një mbipopullim në korridorin drejt qendrës, situatë që krijonte premisa për ndërveprime dhe presione të mundshme mes të dënuarve gjatë ushtrimit të së drejtës së votës.

j. Aksesit i vëzhguesve

Dita e votimit ka pasur një atmosferë përgjithësisht lejuese për veprimtarinë e monitoruesve të KSHH-së, megjithatë, janë konstatuar disa raste në të cilat mund të jetë bllokuar veprimtaria e vëzhguesve, nisur nga krijimi i “artificave” të caktuara institucionale, shpeshherë në emër të “konfidencialitetit” apo “sensitivitetit” të procesit.

Kështu, në Qendrën e Votimit nr. 1494 në Durrës³¹, komisionerët penguan hyrjen e vëzhguesve të akredituar mediatikë, duke cenuar kështu lirinë e medias dhe transparencën e procesit. Ky veprim pengoi raportimin e procesit në kohë reale dhe pa ndikime, duke cenuar parimet e lirisë së informimit dhe mbikëqyrjes publike të zgjedhjeve.

Më tej, në QV 176400 (Tiranë), vëzhguesja e KSHH-së ka fotografuar pozicionimin e një kamere të QV-së të vendosur shumë ulët në raport me tokën, duke dokumentuar kështu një shkelje në kuptim të keqpërdorimit të pajisjeve të administrimit zgjedhor. Pas kësaj, vëzhgueses i janë afruar dy vëzhgues partiakë dhe një anëtar i Komisionit, duke i kërkuar që ta fshijë foton. Pasi është ndjerë e intimiduar, vëzhguesja është larguar nga ambientet e QV-së.

Gjithashtu, në QV 1474 & 1474/1 (Bashkia Durrës), vëzhguesi i KSHH-së nuk është lejuar që të monitorojë procesin e mbylljes së votimit nga anëtarët e KQV-së, duke cituar kështu “konfidencialitetin” e procesit.

³¹[https://web.facebook.com/durreslajm.al/videos/1029540085832356/?__cft__\[0\]=AZWuc5Illi1WKNHQE9tcpN7Y2H-e6A3rSkMFQbGYjeCNNXxAznoGqvBrTPaqSHT-ylgMBBqEOnIOyqTXZ0u2DSKjYiYrimOwnH0svT006h7yQvAdsJw5A0z-PEzojER3H91TU00N9_qmBvCA2a2Seji2iwcCYR4sfC210_GfwccetJRb2dMNbt5FtHu1KnGH4YYe4m4OKXSw-MMkX0lkrb6N&__tn__=-UK-R](https://web.facebook.com/durreslajm.al/videos/1029540085832356/?__cft__[0]=AZWuc5Illi1WKNHQE9tcpN7Y2H-e6A3rSkMFQbGYjeCNNXxAznoGqvBrTPaqSHT-ylgMBBqEOnIOyqTXZ0u2DSKjYiYrimOwnH0svT006h7yQvAdsJw5A0z-PEzojER3H91TU00N9_qmBvCA2a2Seji2iwcCYR4sfC210_GfwccetJRb2dMNbt5FtHu1KnGH4YYe4m4OKXSw-MMkX0lkrb6N&__tn__=-UK-R)



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në përfundim, KSHH vëren se problematikat e konstatuara edhe pse sporadike diktojnë nevojën për përmirësimin e cilësisë dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor, për ndërhyrje të thella në depolitizimin e plotë të komisioneve vendore të administrimit zgjedhor dhe votimit, rregullimin e mekanizmave të kontrollit, trajnimin e komisionerëve në kohë, shmangien e vakancave të momentit të fundit, sigurinë e ambienteve të votimit dhe garantimin e plotë të lirisë dhe fshehtësisë së votimit.

Përveç kësaj, është domosdoshme që KQZ, e cila është vendosur në dijeni të shkeljeve të konstatuara nga KSHH si gjatë ditës së votimit edhe më pas, të ngrejë mekanizmat e duhur që shqyrtojnë me kujdes të gjitha shkeljet dhe problematikat e konstatuara në respektim të parimeve të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë.

6. Procesi i numërimit

Në vijim të mbylljes së procesit të votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, vëzhguesit e KSHH-së vijuan monitorimin e pjesshëm të procesit të numërimit, të vendosura pranë godinave të KZAZ-ve, në 13 Bashki të vendit. Të gjitha VNV-të ishin të vendosura pranë godinave publike dhe ishin pajisur me kamera, të cilat ishin drejtuar ndaj tavolinave dhe transmetonin drejtpërdrejt procesin pranë selisë qendrore të KQZ-së.

Përgjithësisht, në tërësinë e VNV-ve të monitoruara procesi i dorëzimit të kutive u krye konform afateve dhe procedurave të detajuara në Nenin 115 të Kodit Zgjedhor. Njëkohësisht, pranë të gjithë VNV-ve objekt monitorimi është konstatuar zhvillimi i trajnimeve të momentit të fundit, një praktikë e evidentuar dhe më herët nga KSHH si shumë e dëmshme që ul cilësinë e profesionalizmit të komisionerëve dhe ndikon në zbatimin jo të duhur të legjislacionit zgjedhor dhe akteve normative të KQZ-së.

a. Rregullshmëria e procesit të numërimit

Në përgjithësi, procesi i numërimit të votave u zhvillua në përputhje me Kodin Zgjedhor, si dhe u karakterizua nga një transparencë relativisht e mirë.

Megjithatë, në ZAZ Parku Olimpik, i cili ishte ambienti në të cilin po numëroheshin votat e diasporës, aksesueshmëria e fletëve të votimit në monitoret për vëzhguesit jopartiakë ishte i reduktuar. Kjo situatë krijoi shqetësime për transparencën e plotë të procesit në ato pika, duke vënë në dyshim mundësinë e monitorimit të paanshëm. Vëzhguesit kanë referuar se monitori ku afishohen fletët e votimit ka rreshtur së funksionuari, gjë që ka bërë të pamundur kontrollin prej tyre, lidhur me vlefshmërinë dhe punën e kryer prej GNV-ve. Megjithë pretendimet dhe adresimet e përcjella prej vëzhguesve, procesi nuk është pezulluar, duke cenuar rregullshmërinë e procesit të numërimit në këtë Vend të Numërimit të Votave (VNV).



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KSHH vlerëson se mirëfunksionimi i pajisjeve teknike të procesit të numërimit është thelbësor për integritetin dhe mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave, dhe në rast të bllokimit të tyre, procesi i numërimit duhet të pezullohet, deri sa të zgjidhet problemi.

Një problem i rëndësishëm që u evidentua gjatë procesit të numërimit ishte prania e personave të paaautorizuar në vendnumërime. Ky fenomen ishte më i shpeshtë në ZAZ nr. 38 në Tiranë, ZAZ nr. 24 në Durrës, ZAZ nr. 11 në Kukës, ku u vërejtën individë që nuk ishin pjesë zyrtare e komisioneve të numërimit dhe nuk kishin të drejtë të qëndronin pranë vendit ku bëhej numërimi i fletëve të votimit. Kjo prani e paaautorizuar nuk ishte thjesht një shkelje formale, por përbënte një rrezik real për integritetin e procesit. Individë të tillë në disa raste ndërhyjnë në mënyrë direkte ose indirekte në punën e numëruesve, duke krijuar presione të padrejta ose duke tentuar të ndikojnë në rezultatin përfundimtar. Në këtë kontekst, KSHH thekson nevojën e verifikimit të autorizimeve të personave të pranishëm në Vendet e Numërimit të Votave, në mënyrë që të shmangen ndikimet, mbi anëtarët e GNV-ve.

Vëzhguesit raportuan për tensione dhe konflikte që krijoreshin si pasojë e përpjekjeve të vazhdueshme për ndërhyrje në proces nga personat e paaautorizuar të pranishëm në sallë. Ndikimet e jashtme shtriheshin nga presione psikologjike ndaj numëruesve, duke përfshirë vërejtjet për ndryshimin e leximit të rezultatit të fletëve të votimit ose bllokimin e tyre për qëllime të caktuara.

Nga ana tjetër, në disa vendnumërime³² u evidentua mungesa e përgatitjes së duhur të anëtarëve të komisioneve të numërimit, të cilët shpesh hasën vështirësi në menaxhimin korrekt të procesit, duke shkaktuar vonesa dhe konfuzione gjatë numërimit. Kjo mungesë profesionalizmi u pa si një dobësi serioze që kërkon trajnime më të thelluara dhe të organizuara herët në kohë dhe një monitorim më strikt të tyre.

b. Klasifikimi i vlefshmërisë së votave

Në përputhje me nenet 117 dhe 118 të Kodit Zgjedhor, GNV-të kanë detyrimin për të vlerësuar vlefshmërinë e votave. Në përgjithësi vlen të theksohet se nuk ka pasur kontestime lidhur me pavlefshmërinë e fletëve të votimit nga vëzhguesit politikë, por sikurse është evidentuar më herët nga persona të paaautorizuar që qëndronin në këto ambiente.

Vëzhguesit e KSHH-së konstatuan në disa çështje sporadike, lexim jo të saktë të vlefshmërisë së votave nga GNV-të. Kjo u përforcua edhe nga praktika e rinumërimit të votave në Bashkitë Tiranë dhe Fier, pas vendimmarrjes së KAS-it që i hapi rrugë këtij procesi, e cila evidentoi se grupet e

³² ZAZ Parku Olimpik- vëzhguesit e KSHH-së kanë raportuar se në disa raste, numëruesit e GNV-ve kanë grisur gabimisht fletët e votimit, në momentin e nxjerrjes së tyre nga zarfet. Kjo ka shkaktuar një situatë paqartësie dhe konfuzioni, për sa i takon faktit nëse këto vota do të konsideroheshin të vlefshme apo jo.

ZAZ Rroskovec- Këtu, GNV përkatës ka interpretuar se në rastet e fletëve të votimit të shënuar vetëm për subjektin politik dhe jo për kandidatin, vota duhej të shkonte për kandidatin e pare në listë. Në gjykimin tone, kjo përbën një interpretim të gabuar të vullnetit të zgjedhësit.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

numërimit kishin gabuar në disa raste në vlefshmërinë e fletëve të votimit për kandidatë të caktuar, të cilat variuan edhe në marzhe të konsiderueshme që edhe pse nuk sollën ndryshime në rezultat. Rinumërimi në tërësi e cenoi besueshmërinë e publikut në profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë e Komisionerëve të numërimit. Për këto raste, përveç disa deklaratave sporadike të përfaqësuesve të KQZ-së, ende nuk ka një reagim institucional të vetë KQZ-së që të bëjë transparent arsyet se përse kjo ka ndodhur dhe nëse janë konstatuar abuzime apo elementë të kalimit (trafikut) të brendshëm të votave mbidis kandidatëve të të njëjtit subjekt, të cilat duhet të referoheshin për hetime të mëtejshme në organin e prokurorisë.

c. Mbyllja e procesit të numërimit të votave

Në tërësi, KSHH vlerëson ritmet e shpejta të procesit të numërimit, ndërkohë që brenda periudhës tri ditore të monitorimit të pjesshëm të këtij procesi nga KSHH rezultoi i përfunduar në shumicën e ZAZ-ve, objekt vëzhgimi.

Në përmbledhje, megjithëse procesi i numërimit u zhvillua përgjithësisht me transparencë dhe nën vëzhgimin e gjerë të subjekteve të ndryshme, problematikat e evidentuara, si prania e personave të paautorizuar, përpjekjet për ndikim të paligjshëm në leximin e fletëve të votimit dhe mungesa e përgatitjes së duhur të komisionerëve, të dhënat e ndryshme që u prodhuan nga procesi i rinumërimit në Bashkitë Tiranë dhe Fier krijuan variabla seriozë për integritetin zgjedhor. Këto sfida kërkojnë masa të menjëhershme të reformimit të legjislacionit zgjedhor për të depolitizuar komisionerët e numërimit dhe rritur profesionalizmin e tyre, si dhe zbatim rigoroz të ligjit duke përmirësuar sistemin e mbikëqyrjes, forcuar parimin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë brenda administrantës zgjedhore në të gjitha nivelet e saj, duke garantuar që në zgjedhjet e ardhshme të respektohen në mënyrë rigoroz standardet demokratike dhe ligjore.

7. Rekomandime

1. KSHH ripërsërit rekomandimin e tij se reforma e mëtejshme zgjedhore kërkon konsensus dhe dialog të gjerë politik, transparencë dhe gjithëpërfshirje. Është e nevojshme të merren në shqyrtim rekomandimet e OSBE/ODIHR-it të pasqyruara në raportet e viteve të fundit³³.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor nuk duhet të jenë monopol i partive politike dhe as të realizohen në periudha të afërta zgjedhore, por të marrin në konsideratë standartet dhe praktikën e mira ndërkombëtare. KSHH rekomandon shmangien e konsultimeve formale në reformimin e ardhshëm

³³ Shumë raporte të OSBE/ODIHR-it ose nuk janë bërë objekt diskutimi parlamentar ose nuk janë diskutuar fare, sikurse janë ato të viteve 2009, 2013, 2015, 2017, 2019, 2021, 2023. Thuajse në të gjitha këto raporte, në pjesën hyrëse thuhet se “Këto rekomandime duhet të lexohen së bashku me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it që nuk janë adresuar ende”.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

zgjedhor përkundrejt nevojës për realizimin e dëgjësive efektive me ekspertët, si dhe organizatat dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Sa më sipër, KSHH rekomandon krijimin e një Komisioni të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore menjëherë pasi të konstituohet Parlamenti i ri, për të filluar menjëherë nga puna, bazuar në parimet dhe standartet e përmendura më sipër.

2. Zgjedhjet për Kuvendin e RSH vërtetuan edhe një herë se anëtarët e Komisioneve Zgjedhore lokale, në mjaft raste, profesionalisht nuk ishin në nivelin e duhur. Në punën e tyre u vërejt edhe njëanshmëria partiake. Për rrjedhojë qëndron nevoja imediate për të marrë në shqyrtim Rekomandimin prioritar e të hershëm të OSBE/ODIHR-it, për depolitizimin total të tyre.

3. Nga disa parti të vogla ka patur ankesa se sipas sistemit zgjedhor në fuqi cenon barazinë e votës midis zonave, dhe për rrjedhojë shpërndarja e mandateve dhe sistemi zgjedhor në tërësi kanë nevojë të rishikohen. KSHH, duke patur në konsideratë argumentat e dhëna statistikisht nga këto subjekte, rekomandon që kjo çështje të jetë objekt diskutimi gjithëpërfshirës në kuadër të reformës së ardhshme zgjedhore.

4. Në zgjedhjet e 11 Majit 2025, kandidatëve të listave preferenciale që pretendonin për dëmtim të interesave të tyre të ligjshme, ju refuzuan ankesat nga KAS-i dhe Kolegji Zgjedhor, referuar pikës 1 të nenit 124 të Kodit Zgjedhor. Në këtë dispozitë nuk parashikohet e drejta e ankimit të kandidatëve të partive politike. KSHH sugjeron ndryshimin e kësaj dispozite, ku të parashikohet e drejta për ankim edhe të kandidatëve të partive politike (bazuar në Opinionin e Komisionit të Venecias dhe ODIHR-it).

5. Lidhur me kompetencat e KQZ-së për votimin jashtë vendit dhe procedurat e votimit përkatës jashtë vendit (nenet 24 dhe 26 të Kodit Zgjedhor) kemi mendimin se realizimi më i mirë dhe i besueshëm i kësaj procedure duhet të realizohet në tërësi, duke patur parasysh arritjet dhe vështirësitë e rezultuara në zgjedhjet e 11 Majit 2025. Për këtë rekomandojmë që çështjet kryesore duhen zgjidhur në dispozitat e Kodit Zgjedhor, me qëllim që KQZ-ja të mos vihet në kushte të vështira duke marrë attribute të legjislativit. Përvoja e vendeve të tjera sigurisht që është e rëndësishme, por emigracioni ynë ka veçoritë e tij.

Për sa i përket votimit me postë, mendojmë se duhet patur parasysh Kodi i Praktikës së Mirë të Komisionit të Venecias, të vitit 2002 ku thhet *“Votimi me postë duhet të lejohet vetëm nëqoftëse shërbimi postar është i sigurtë dhe i besueshëm. E drejta për të përdorur votimin me postë mund të kufizohet vetëm për njerëzit në spital ose në burg ose njerëzit me aftësi të kufizuara për të lëvizur ose zgjedhësve që jetojnë jashtë vendit, por duhet të merren masa për të parandaluar mashtrimin dhe shantazhin”* (shih fq.9).

6. Praktika ka vërtetuar se sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që mundësojnë identifikimin elektronik të votuesve, votimin elektronik dhe verifikimin paszgjedhor,



Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

nëse ato i nënshtrohen parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe efikasitetit janë mjetet më të besueshme dhe që garantojnë dhënien e shpejtë të rezultateve. Edhe në këto zgjedhje, votimi elektronik i pilotuar në dy zona evidentoi avantazhet e shpejtësisë dhe efikasitetit të tij, në raport me numërimin manual. Duke qenë se votimi elektronik është më i shpejtë dhe i besueshëm në nxjerrjen e rezultatit sugjerohet zgjerimi i këtij votimi në zgjedhjet e ardhshme, pas konsultimit me partitë politike dhe me ekspertizën e ekspertëve të kualifikuar të fushës, duke mos cenuar diskrecionin përfundimtar të vendimmarrjes së KQZ për të caktuar përfundimisht metodën dhe zonat e pilotimit të votimit elektronik.

7. Nga një proces zgjedhor në tjetrin vërtetohet e njëjta shkelje: zgjedhësit nuk njoftohen në banesat e tyre për shkak të mungesës së fondit që duhet të akordohet nga Ministria e Brendshme. Duke patur parasysh se koha në dispozicion për këtë njoftim është mjaft e shkurtër sipas nenit 52 të Kodit Zgjedhor (60 ditë nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë), KSHH sugjeron që ky afat të zgjatet deri në 15 ditë para datës së zgjedhjeve. Gjithashtu, i sugjerojmë KQZ-së që në raste të tilla, të përsëritura të mospërmblidhjes së këtij detyrimi të zbatojë sanksione administrative sipas nenit 71, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

8. Edhe në këto zgjedhje, subjektet zgjedhore e filluan fushatën shumë kohë para afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor. Një praktikë e tillë jo vetëm shoqërohet me shpenzime të shumta që ja kalojnë fushatës së ligjshme, por krijojnë pabarazi të theksuar për partitë më të vogla. KSHH sugjeron që KQZ-së në raste të tilla t'i jepet kompetencë jo vetëm të ndërhyjë, por kur është e nevojshme të zbatojë dhe sanksione, në mbështetje të nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

9. Ndalimi i përdorimit të burimeve publike për qëllime elektorale, vlerësojmë se duhet të rishikohet në parashikimet e Kodit Zgjedhor duke e shtrirë këtë ndalim që prej datës së dekretimit të zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe mos e kufizuar atë në raport me faktin nëse një parti politike është regjistruar apo jo si subjekt zgjedhor.

10. Televizionet, sipas parashikimit të nenit 80 pika 1 mbi radiotelevizionin publik dhe nenit 84 për radiot dhe televizionet private, të Kodit Zgjedhor i kanë kushtuar një fraksion kohor minimal subjekteve zgjedhore të cilat janë parti joparlamentare apo kandidatë të propozuar nga zgjedhësit. Këto dispozita vlen të rishikohen, me qëllim që të garantojnë raportim mediatik pluralist dhe gjithëpërfshirës për subjektet garuese.

11. Kryesisht në edicionet informative, KSHH vijon të konstatojë me shqetësim se materialet audio-vizuale të regjistruara nga partitë politike apo kandidatët përbëjnë pjesën dërrmuese të materialeve të shfaqura në televizion, në përputhje me Nenin 84/1 të Kodit Zgjedhor, i cili legjitimon transmetimin e tyre. KSHH rekomandon rishikimin e këtij neni në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR, me qëllim që t'i jepet fund kësaj praktike që cënon lirinë e medias dhe të drejtën e publikut për t'u informuar me paanshmëri.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

12. KSHH i rekomandon KQZ-së që të realizojë hetime administrative të shpejta, efikase dhe objektive të rasteve apo sinjalizimeve të lidhura me shpërdorimin e aseteve publike, duke treguar rigorozitet në zbatimin e ligjit dhe sanksionimin e shkelësve konform nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe akteve rregullatore të saj.

13. KSHH i sugjeron KQZ-së të vendosë në lëvizje mekanizmat e brendshëm apo të jashtëm (me anë të organeve të drejtësisë) të hetimit të përgjegjësive të Komisionerëve të numërimit, lidhur mangësitë e vërejtura në leximin dhe vlefshmërinë e fletëve të votimit, në ato Bashki ku KAS ka vendosur të kryerjë ri-numërimin e votave.

Duke marrë shkas nga kjo problematikë, KSHH vlerëson se gjithashtu është e nevojshme që në zgjedhjet e ardhshme, KQZ të rishikojë udhëzimet e saj lidhur me llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e tyre. Kjo pasi në pikën 4 të nenit 117 të Kodit Zgjedhor ku thuhet “Vlerësimi i votave synon të identifikojë sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhësit”. Vlerësimi në praktikë i votave ka nevojë të ilustruhet me shembuj sa më gjithëpërfshirës nga KQZ, pasi ka raste kur interpretimi i vullnetit të zgjedhësve kërkon një kujdes të veçantë në vlerësim që shkon përtej anës formale se ku ka vendosur shenjën brenda apo jashtë kutisë si dhe llojin e shenjës që është përdorur.

Marrim shkas nga ky sugjerim, duke patur parasysh orientimet e dhëna nga KQZ për vlefshmërinë e votave për zgjedhjet parlamentare si dhe kritikën që OSBE/ODIHR ka bërë për legjislacionin zgjedhor të kohës së vendit tonë, për nenin 92/4 të Kodit Zgjedhor të vitit 2003, ku vota shpallëj e pavlefshme nëse shenja e zgjedhësit nuk ishte saktësisht brenda hapësirës së veçantë ose i ka kaluar kufizimet e hapësirës së veçantë. Është kjo arsyeja që OSBE/ODIHR dhe Komisionin i Venecias kanë sugjeruar ndryshimin e dispozitës, për të lejuar më shumë liri në përcaktimin e vlefshmërisë së votës, e për rrjedhojë zgjedhje politike për zgjedhësit.

14. KSHH i rekomandon KQZ-së që në kuadrin e transparencës, në zbatim të nenit 123/3 të Kodit Zgjedhor “Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve”, të informonte opinionin publik për rezultatet e arritura dhe në mënyrë të veçantë, nëse në informacionet që ka marrë ka pasur ose jo edhe çështje me element të veprave penale që i ka denoncuar në organet përkatëse të procedimit penal.

15. KSHH i rekomandon që trajnimi i KZAZ-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit të mos jetë formal dhe i vonuar në kohë. Nisur nga praktika e dëmshme e trajnimit, veçanërisht të grupeve të numërimit një ditë para numërimit ose disa orë para fillimit të tij, trajnimi dhe certifikimi i detajuar dhe cilësor i komisionerëve duhet të jetë prioritet, duke u fokusuar jo vetëm në njohjen e procedurave, por edhe në menaxhimin e situatave të paparashikuara dhe respektimin e plotë të ligjit.

16. Forcimi i masave për kontrollin e aksesit në vendvotime dhe vendnumërime është thelbësor për të parandaluar praninë e personave të paautorizuar dhe për të shmangur çdo formë



Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ndikimi të paligjshëm. Kësaj praktike të dëmshme duhet ti jepet një zgjidhje përfundimtare në zgjedhjet e ardhshme.

17. Duke patur në konsideratë ndryshimet dhe vakancat që krijohen në përbërje të këtyre trupave të administrimit zgjedhor në nivel të dytë dhe të tretë, sikurse ishte në këto zgjedhje në radhët e anëtarëve të KQV-ve, ne rekomandojmë që të rishikohen dispozitat përkatëse ligjore.

18. Gjithashtu, infrastruktura dhe logjistika duhet të riorganizohen për të siguruar shpërndarje të plotë dhe në kohë të materialeve zgjedhore, përfshirë sigurimin e energjisë dhe funksionimin e pajisjeve teknologjike që mbështesin procesin, siç janë pajisjet PEI.

19. KShH sugjeron të përmirësohet edhe transparenca dhe qasja e lirë e vëzhguesve dhe mediave gjatë të gjitha fazave të procesit, për të garantuar raportim të pavarur dhe në kohë reale, që është kyç për besueshmërinë e zgjedhjeve.